



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendhdodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin KompjuterikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja JavorePër sinjaliziminTë Guximshëm Pa Armë

Breaking News:

Policia e Shtetit/Njoftim
DVP Vlorë, gjatë 24 orëve të fundit
Policia e Shtetit/Ftesë për median
Tiranë – Finalizohet operacioni “Deceiver”
Korçë – Vihen në pranga 2 shtetas, procedohet penalisht 1 tjetër



LajmetOperacionet

02/06/2024

Elbasan – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Vëllezërit”, Kundër Armëmbajtjes Pa Leje

Elbasan/Finalizohet operacioni policor i koduar “Vëllezërit”, kundër armëmbajtjes pa leje.

Operacioni u zhvillua nga Komisariati i Policisë Elbasan, si rezultat i hetimit me metoda proaktive të informacioneve të siguruara nga inteligjencia policore.

Gjatë operacionit, në banesat e 2 vëllezërve u gjetën 1 armë zjarri kallashnikov, 1 armë gjahu, 3 armë pneumatike, 1 pushkë trofe, 1 palë dylbi, 2 karikatorë, municion luftarak dhe 1 mjet prerës (thikë).

Vihet në pranga njëri prej vëllezërve dhe procedohet në gjendje të lirë, për arsye shëndetësore, vëllai tjetër.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Elbasan, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të posedimit të kundërligjshëm të armëve të zjarrit, në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional mbarëkombëtar “Sundimi i ligjit”, kanë siguruar informacion për 2 raste të posedimit të armëve të zjarrit.

Ky informacion është hetuar me metoda proaktive, në drejtimin e Prokurorisë së Elbasanit, dhe si rezultat është finalizuar operacioni policor i koduar “Vëllezërit”.

Në kuadër të këtij operacioni, në fshatin Gjergjan, në banesat e shtetasve A. M., 65 vjeç dhe B. M., 57 vjeç, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale:

- 1 armë zjarri kallashnikov me 2 karikatorë me 80 fishekë;
- 1 armë gjahu gjysmë automatike;
- 1 armë zjarri pushkë (trofe);
- 2 pushkë pneumatike;
- 1 armë pneumatike me dylbi të montuar;
- 1 palë dylbi;
- 1 mjet prerës (thikë) i kombinuar me përforcues grushti.

Në vijim të veprimeve procedurale për këto raste, u arrestuan në flagrancë shtetasi B. M., 57 vjeç, dhe u procedua në gjendje të lirë, për arsye shëndetësore, vëllai i tij, shtetasi A. M., 65 vjeç.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ DVP Dibër – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohen penalisht 3 të tjerë

Durrës – Kanosën me armë zjarri, një 20-vjeçar, Policia parandalon përshkallëzimin e konfliktit ▶